Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0006

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Isa Hasani Anëtar dhe Batisha Ibrahimi Anëtare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "TONI O.P.", kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në objektet e Trashëgimisë Kulturore në gjithë Republikën e Kosovës - Faza e katërt" me numër të prokurimit 207-24-10543-5-1-1, me 17.03.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "TONI O.P." me nr. 2025/0006, e datës 03/01/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në objektet e Trashëgimisë Kulturore në gjithë Republikën e Kosovës - Faza e katërt" me numër të prokurimit 207-24-10543-5-1-1.

2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimi të përshkruar sipas pikës 1. të këtij dispozitivi

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 08.10.2024, “MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në objektet e Trashëgimisë Kulturore në gjithë Republikën e Kosovës - Faza e katërt” me nr. të prokurimit: 207-24-10543-5-1-1. Ndërsa me datën 19.12.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie te kontratës.,

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: LOT 2: 452,778.28 Euro.

Me 23.122024, OE “TONI O.P.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 24.12.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03/01/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “TONI O.P.” me nr. 2025/0006 për lidhur me aktivitetin “Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në objektet e Trashëgimisë Kulturore në gjithë Republikën e Kosovës - Faza e katërt” me nr. të prokurimit: 207-24-10543-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “TONI O.P.” janë parashtruar si në vijim: *"Për shkak se AK- MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT: - ne mënyrë te kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pasi qe i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e AK te vendosura ne njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit.Sqarojmë ne mënyrë te detajuar: Autoriteti Kontraktues – AK MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT ne mënyrë te kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit ku si arsye te eliminimit ka cekur si e poshtë: Ndërsa në NJK dhe në DT ka kërkuar tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional: ndërsa tek kërkesa e.) Kërkesa për LOT 1, 2, 3 dhe 4 Lista e stafit profesional 2.1 Një (1) Inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Master) 2.2. Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë konstruktiv (ose Master) 2.3 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (ose Master) drejtimi hidroteknik 2.4 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (ose Master) 2.5 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i makinerisë (ose Master) E gjithë lista e stafit të kërkuar në kërkesën numër 2 nga Autoriteti kontraktues duhet të kenë;e. Se paku njeri prej tyre i paraqitur në listën e stafit profesional duhet të jenë të licencuar me licencëA1. Në rast të posedimit të Licencës A1, inxhinieri i arkitekturës duhet të prezantojë vetëm kopjen e noterizuar të licencës ose kopjen e noterizuar të vendimit të Bordit të Licencimit që është i licencuar në kategorinë A-1 dhe Kontratën me O.E të vulosur dhe nënshkruar nga të dyja palët.Pra siç po shihet nga vet kërkesa dhe nga arsyeja e eliminimit nga ana e AK –se, AK është ne kundërshtim me vetveten pasi qe nuk ka kërkuar qe Ing i Arkitekturës te jetë kërkesë e veçantë.Pra AK na ka eliminuar ne kundërshtim me LPP-ne pasi qe një arsye e eliminimit për te*

cilën na ka eliminuar AK nuk ka qene kërkesë e AK-se ne NJK dhe DT.AK me këtë veprim ka vepruar ne kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-së ku thuhet: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".Neve e ne listën e stafit profesional i kemi dy arkitekt: 1. Z.Emin Demaku dhe 2. z.Muzafer Asllani, ku sikur një kërkesë e tille te ishe ne NJK dhe DT shumë lehtë kemi mundur qe ta emërojmë z.Muzafer Asllanin Menaxher te Kontratës por një kërkesë e tille nuk ka qene as ne NJK dhe as ne DT.Por kërkese ka qenë që e. Se paku njeri prej tyre i paraqitur në listen e stafit profesional duhet të jenë të licencuar me licencë A1 ku e kemi edhe njërin nga stafi me A1 si me poshtë;Ne si Operator Ekonomik jemi te dëmtuar nga ky vendim i AK i cili është i kundërligjshëm dhe një tentim për ta dëmtuar Buxhetin e Kosovës ne mënyrë te kundërligjshme pasi qe i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT si dhe jemi me te lirë.Këtë pretendim si me lart e kemi parashtruar edhe ne kërkesën për rishqyrtim te datës 23.12.2024 dhe AK me datën 24.12.2024 na kthen përgjigje ne vendimin ku e refuzon kërkesën tone për rishqyrtim me arsyetimin e njëjtë sikurse ne letrën standarde për eliminim pra AK këmbëngul se kërkesë e dosjes ka qene një ing i veçantë qe nuk është e vërtetë sepse AK ka kërkuar qe njeri nga stafi te ketë licence A1 si me poshtë kërkesa e AK-se e. Se paku njeri prej tyre i paraqitur në listën e stafit profesional duhet të jenë të licencuar me licencë A1.Pra shihet qarte se AK na ka dëmtuar kundërligjshëm pasi qe i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e tyre te vendosura ne NJK dhe DT dhe kemi ofertuar me çmimin me te ulet.Gjithashtu neve nuk kemi ngritur pretendime kundër OE-ve me te shtrenjtë se neve pasi qe neve e kemi patur çmimin me te ulet dhe i kemi plotësuar te gjitha kërkesat sikur te ishim me te shtrenjte do ti kishim patur pretendimet tona por nuk kem pasur nevoje qe te merremi me OE-te e tjerë pasi qe ligjërisht neve na takon Lloti 2, sikur AK te kishte vlerësuar sipas ligjit dhe procedurave te KRPP-se neve do te na kish shpallur fitues.

Krejt ne fund:Ne si Operator Ekonomik jemi te dëmtuar nga ky vendim i AK i cili është i kundërligjshëm dhe një tentim për ta dëmtuar Buxhetin e Kosovës ne mënyrë te kundërligjshme pasi jemi te vetmit operator me çmim me te lire qe kemi ofertuar me tender te përgjegjshëm pasi qe i kemi plotësuar te gjitha kërkesat AK-se ndërsa OE-te e rekomanduar për kontrate jane me qindra mije euro me te shtrenjtë dhe nuk i kane plotësuar kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë edhe Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ku Qëllimi i ketij neni është qe Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.Autoriteti kontraktues ne këtë aktivitet te prokurimit, ekzaminimin,

vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, ku AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 60 të LPP-së ku kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, ku neve kemi ofertuar me ofertuar me Tender të përgjegjshëm dhe me Çmimin më te ulët.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "TONI O.P." konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1 Qëllimi, Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, Neni 65 Pranueshmëria e Kandidateve ose tenderuesve Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse te KRPP-së. Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Kërkojmë nga OSHP qe ta detyroj AK-ne qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat e ligjit te prokurimit publik gjithashtu t'i respektoj kërkesat e veta te cilat vet i ka vendosur ne njoftimin për kontrate dhe në dosje te tenderit dhe te nxjerr; vendim te APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik: TONI O.P. Lidhur me aktivitetin e prokurimit:

Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në objektet e Trashëgimisë Kulturore në gjithë Republikën e Kosovës - Faza e katërt Per Lot 2, Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në objektet e Trashëgimisë Kulturore në gjithë Republikën e Kosovës - Faza e katërt në Rajonin e Prizrenit me nr. te prokurimit: 207-24-10543-5-2-1 dhe Nr i brendshëm: 207-24-094-5-2-1 te inicuar nga AK- MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT ANULOHET njoftimi për dhënie te kontratës Lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në objektet e Trashëgimisë Kulturore në gjithë Republikën e Kosovës - Faza e katërt Për Lot 2, Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në objektet e Trashëgimisë Kulturore në gjithë Republikën e Kosovës - Faza e katërt në Rajonin e Prizrenit. me nr. te prokurimit: 207-24-10543-5-2-1 dhe Nr i brendshëm: 207-24-094- 5-2-1 te inicuar nga AK- MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT dhe lënda kthehet ne Rivlerësim Për Lot 1, Lot 2, Lot 3 dhe Lot 4, Dhe pas rivlerësimit te shpërblehemi me kontrate për Lot 2, pasi qe kemi ofertuar konform nenit 60 te LPP-se me tender të përgjegjshëm dhe çmimin me te ulët"

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Përgjigje- Pretendimi ankimor 1: "*Pretendimi është i pabazuar sepse ne kriteret e përdorura për procedurën: Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në objektet e Trashëgimisë Kulturore në gjithë Republikën e Kosovës - Faza e katërt mc numër 207-24-10543-5-1-1 dhe 207-24-094-5-1-1.*

AK ka paraqitur: Kërkesa për LOT 1,2, 3 dhe 4 Kriteri numër 2. Caktimi i Menaxherit të kontratës Vendimi për përcaktimin e menaxherit të kontratës, i cili duhet të jetë Master ose Jnxhinier i Arkitekturës ose i Ndërtimtarisë-Konstruktiv. Vendimi duhet lë përmbajë të dhëna bazike mbi procedurën aplikuese (Emrin e Autoritetit, Emërtimin e procedurës, numrin e prokurimit). Menaxheri i kontratës duhet të prezantojë a. Diplomën universitare të noterizuar. b.

Kontratën c punës (të nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). c. Dëshmi për përvojë të punës se paku 5 vile në fushën e trashëgimisë kulturor ose të punëve të ngjashme (të dëshmohen me CV të nënshkruar dhe me diplomë pas titullit Master osc Inxhinier), d. Së paku një referencë të punës në menaxhim të kontratave- mbikëqyrje të implementimit të projekteve të ngjashme;

Kriter i veçanta krahas stafi pra, AK ka kërkuar një Menaxher i cili nuk është kërkuar te këtë liccncë. Operatori Ekonomik ka paraqitur z. Emin Demaku si Menaxher i Kontratës i cili ka Licence Al. Mirëpo te kriteri: Kërkesa për LOT 1,2,3 dhe 4 Lista c stafit profesional 2.1 Një (1) inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Mastcr) 2.2. Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë konstruktiv (ose Master) 2.3 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (ose Master) drejtimi hidroteknik 2.4 Një (I) I Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (ose Master) 2.5 Një (1) I Inxhinier i diplomuar i makinerisë (ose Master) E gjithë lista e stafit të kërkuar në kërkesën numër 2 nga Autoriteti kontraktues duhet të kenë;a. Diploma universitare e noterizuar.b. Kontrata c punës (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE).c. Dëshmi për përvojë të punës se paku 5 vite për në fushën e trashëgimisë kulturore ose punë të ngjashme (të dëshmohet me CV c nënshkruar nga i angazhuari), përjashtimisht pikës 2.3, 2.4 dhe 2.5 ku përvoja e punës mund te jete minimumi 2 vite.d. Dëshmi qe secili prej tyre ka se paku një referencë të punës që ndërlidhet me njërën nga natyrat c punës në restaurim ose konservim ose renovime të objekteve të trashëgimisë kulturore, përjashtimisht pikave2.3, 2.4 dhe 2.5 ku nuk kërkohej dëshmi,e. Se paku njeri prej tyre i paraqitur në listën c stafit profesional duhet (c jenë (ë licencuar me licencë Al. Në rast të posedimit të Licencës Al, inxhinjei i arkitekturës duhet të prezantojë vctëni kopjen e noterizuar të licencës ose kopjen e noterizuar të vendimit të Bordit të Licencimit që është i licencuar në kategorinë A-1 dhe Kontratën me O.E të vulosur dhe nënshkruar nga të dyja palët.Operatori Ekonomik TONl OP / ne listën e stafit 2.1 Një (I) Inxhinier i diplomuar i arkitekturës (osc Master) 2.2. Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë konstruktiv (ose Master) 2.3 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (ose Master) drejtimi hidroteknik 2.4 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (ose Master) 2.5Një (1) 1 Inxhinicr i diplomuar i makinerisë (ose Masler) Asnjeri prej tyre nuk ka arritur ta plotësojë kriterin e). Se paku njeri prej tyre i paraqitur në listën e stafit profesional duhet të jenë të licencuar me licencë Al. Në rast të posedimit të Licencës Al, inxhinieri i arkitekturës duhet të prezantojë veten kopjen e noterizuar të licencës ose kopjen e noterizuar të vendimit të Bordit të Licencimit që është i licencuar në kategorinë A-1 dhe Kontratën me O.E të vulosur dhe nënshkruar nga të dyja palët.Kjo shihet qartë pasi qe edhe vet OE e pranon një gjë te tillë në Kërkesën për rishqyrtim: Pra siç po shihet nga vet kërkesa dhe nga arsyeja e eliminimit nga ana e AK -se, AK është ne kundërshtim me vetveten pasi qe nuk ka kërkuar qe Ing i Arkitekturës te jetë kërkesë e veçantë.Pra, paraqesim se Kriteri 1. Lidhur me Menaxherin c Kontratës është kriter i veçante dhe jo kriter i stafit profesional. 1 bije qartë se OE e ka kuptuar se Menaxheri i Kontratës (ku nuk kërkohet licence) është kriter i veçante dhe stafi ku njeri prej tyre duhet te jete i licencuar është kriter tjetër i veçantë. Të gjithë Operatoret Ekonomik e kanë kuptuar një çështje të tillë pasi qe AK vendos gjithmonë kritere të qarta dhe nuk lëne konfuzione të Operatoret Ekonomik. 1 bije se Kërkesa për rishqyrtim është kërkesë e pabazuar."

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 13.01.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0006/2025, ndërsa me datë 24.01.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0006/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit

shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet *si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës për LOT 2 dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.*

Lidhur me pretendimet e OE "TONI O.P." eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0006 ka vlerësuar si në vijim: "Pretendimi i OE ankues: *OE ankues në ankesë pretendon se i plotëson kërkesat e AK-së, për arsye se në listën e stafit profesional gjenden dy inxhinier të arkitekturës, dhe se kërkesa ka qenë të paktën njëri prej tyre i paraqitur në listën e stafit profesional të jenë me licencën A1, dhe po që se do të ishte një inxhinier i veçantë siç këmbëngulë AK, atëherë lehtë e kishim ndërruar para ofertimit, mirëpo AK në DT nuk ka kërkuar një inxhinier të veçantë, por së paku njëri prej tyre. Andaj AK nuk ka vlerësuar ofertat sipas nenit 56.3 të LPP-së.*

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues:" *Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të dokumentuara në E-prokurim sqaron se, kërkesa e AK-së në DT 9.1& 9.2- Aftësitë teknike dhe profesionale është:Kërkesa për LOT 1, 2, 3 dhe 4 Kriteri numër 2. Caktimi i Menaxherit të kontratësDëshmia e kërkuar: Vendimi për përcaktimin e menaxherit të kontratës, i cili duhet të jetë Master ose Inxhinier i Arkitekturës ose i Ndërtimtarisë-Konstruktiv. Vendimi duhet të përmbajë të dhënat bazike mbi procedurën aplikuese (Emrin e Autoritetit, Emërtimin e procedurës, numrin e prokurimit). Menaxheri i kontratës duhet të prezantojë a. Diplomën universitare të noterizuar. b. Kontratën e punës (të nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). c. Dëshmi për përvojë të punës se paku 5 vite në fushën e trashëgimisë kulturore ose të punëve të ngjashme (të dëshmohet me CV të nënshkruar dhe me diplome pas titullit Master ose Inxhinier). d. Së paku një referencë të punës në menaxhim të kontratave – mbikëqyrje të implementimit të projekteve të ngjashme; Kërkesa:Kërkesa për LOT 1, 2, 3 dhe 4 Lista e stafit profesional 2.1 Një (1) Inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Master) 2.2. Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë konstruktiv (ose Master) 2.3 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (ose Master) drejtimi hidroteknik 2.4 Nje Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (ose Master) 2.5 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i makinerisë (ose Master)Dëshmia e kërkuar: E gjithë lista e stafit të kërkuar në kërkesën numër 2 nga Autoriteti kontraktues duhet të kenë; a. Diploma universitare e noterizuar. b. Kontrata e punës (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). c. Dëshmi për përvojë të punës se paku 5 vite për në fushën e trashëgimisë kulturore ose punë të ngjashme (të dëshmohet me CV e nënshkruar nga i angazhuari), përjashtimisht pikës 2.3, 2.4 dhe 2.5 ku përvoja e punës mund te jete minimumi 2 vite. d.Dëshmi që secili prej tyre ka se paku një referencë të punës që ndërlidhet me njërën nga natyrat e punës në restaurim ose konservim ose renovime të objekteve të trashëgimisë kulturore, përjashtimisht pikave 2.3, 2.4 dhe 2.5 ku nuk kërkohet dëshmi. e. Se paku njeri prej tyre i paraqitur në listën e stafit profesional duhet të jenë të licencuar me licencë A1. Në rast të posedimit të Licencës A1, inxhinjeri i arkitekturës duhet të prezantojë vetëm kopjen e noterizuar të licencës ose kopjen e noterizuar të vendimit të Bordit të Licencimit që është i licencuar në kategorinë A-1 dhe Kontratën me O.E të vulosur dhe nënshkruar nga të dyja palët.Gjerësa në ofertën e OE ankues gjendet lista e stafit profesional, në të cilin gjendet menaxheri i kontratës me profesion Inxhinier i Arkitekturës, i cili posedon Licencën A1, dhe në rastin konkret, kërkesa e AK-së është Lista e stafit profesional në të cilin hyn edhe menaxheri i kontratës, për arsye se kërkesa tek kriteri numër 2 "Caktimi i menaxherit të kontratës" është kërkesa që të caktohet një menaxher i kontratës e cila është e bashkëlidhur me listën e stafit profesional. Andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.*

Si përfundim, sipas sqarimeve më lartë, pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar dhe konform ankesës së OE ankues për LOT 2, rekomandohet që LOT 2 të kthehet në rivlerësim, me qëllim që të respektohet neni 1, 6, 7, 56 dhe 59 i LPP-së."

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk ka falur besimin konstatimeve lidhur me pretendimin e parë ekspertit shqyrtues sa i përket konstatimeve për pretendimin e dytë.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktuees gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhurme aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë ankimor Paneli shqyrtues nuk është pajtuar me konstatimin e ekspertit shqyrtues pasi që nuk është analizuar arsyetimi nga AK mbi eliminimin e OE ankues në raport me pretendimin ankimor dhe kërkesat e parashtruara në DT.

PSH gjatë shtjellimit në tërësi të dokumentacionin ka vërejtur se në DT, kanë qenë të parashtruara ndër të tjera edhe dy kërkesa të cilat kanë qenë të ndara njëra nga tjetra, e para është kërkuar Caktimi i Menaxherit të kontratë më saktsisht Vendimi për caktimin e menaxherit të kontratës dhe e dyta kërkesë ka qenë lista e stafit professional, prandaj PSH ka trajtuar, tek:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 :

1.Kapaciteti teknik dhe professional *Kërkesa për LOT 1,2, 3 dhe 4 Kriteri numër 2. Caktimi i Menaxherit të kontratës* ***Dëshmia e kërkuar dokumentare:****Vendimi për përcaktimin e menaxherit të kontratës, i cili duhet të jetë Master ose Inxhinier i Arkitekturës ose i Ndërtimtarisë-Konstruktiv. Vendimi duhet lë përmbajë të dhëna bazike mbi procedurën aplikuese (Emrin e Autoritetit, Emërtimin e procedurës, numrin e prokurimit). Menaxheri i kontratës duhet të prezantojë a. Diplomën universitare të noterizuar. b. Kontratën c punës (të nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE). c. Dëshmi për përvojë të punës se paku 5 vile në fushën e trashëgimisë kulturor ose të punëve të ngjashme (të dëshmohen me CV të nënshkruar dhe me diplomë pas titullit Master osc Inxhinier), d. Së paku një referencë të punës në menaxhim të kontratave- mbikëqyrje të implementimit të projekteve të ngjashme.***

2.Kapaciteti teknik dhe professional:*Kërkesa për LOT 1,2,3 dhe 4* ***Lista e stafit profesional*** *2.1 Një (1) inxhinier i diplomuar i arkitekturës (ose Mastcr) 2.2. Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë konstruktiv (ose Master) 2.3 Një (1) 1 Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (ose Master) drejtimi hidroteknik 2.4 Një (I) I Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (ose Master) 2.5 Një (1) I Inxhinier i diplomuar i makinerisë (ose Master).* ***Dëshmia e kërkuar dokumentare*** *: E gjithë lista e stafit të kërkuar në kërkesën numër 2 nga Autoriteti kontraktues duhet të kenë;a. Diploma universitare e noterizuar.b. Kontrata c punës (e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE).c. Dëshmi për përvojë të punës se paku 5 vite për në fushën e trashëgimisë kulturore ose punë të ngjashme (të dëshmohet me CV c nënshkruar nga i angazhuari), përjashtimisht pikës 2.3, 2.4 dhe 2.5 ku përvoja e punës mund te jete minimumi 2 vite.d. Dëshmi qe secili prej tyre ka se paku një referencë të punës që ndërlidhet me njërën nga natyrat c punës në restaurim ose konservim ose renovime të objekteve të trashëgimisë kulturore, përjashtimisht pikave2.3, 2.4 dhe 2.5 ku nuk kërkohej dëshmi,e. Se paku njeri prej tyre i paraqitur në listën c stafit profesional duhet (c jenë (ë licencuar me licencë Al. Në rast të posedimit të Licencës Al, inxhinjei i arkitekturës duhet të prezantojë vetëni kopjen e noterizuar të licencës ose kopjen e noterizuar të vendimit të Bordit të Licencimit që është i licencuar në kategorinë A-1 dhe Kontratën me O.E të vulosur dhe nënshkruar nga të dyja palët* **.**

Bazuar në përshkrimin e kërkesave të parashtruara në DT, konstatohet se kërkesat në DT kanë qenë të ndara sipas dëshmive të dokumentuara dhe me kushte te veçanta për secilën kërkesë. PSH vlerëson faktin se AK në kërkesat e parashtruara dëshmitë e kërkuara janë të specifikuara dhe të qartësuara në mënyër të sakt, po ashtu PSH vlerëson faktin se AK ka zbatuar dispozitat ligjore të nenit 7 të L.P.P- së duke bërë përpilimit e kërkesave dhe specifikimeve teknike në mënyrë të drejtë dhe të njëjtat duke mos qenë diskriminuese dhe në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik. Me këtë sqarim PSH konstaton se AK duke përpiluar të njëjtat kërkesa ka specifikuar ***qëse paku njeri prej tyre i paraqitur në listën c stafit profesional duhet c) jenë ë) licencuar me licencë Al,*** me këtë rast në këtë kërkesë AK operatorëve ekonomik ofertues iu ka dhënë mundësinë që tek cilido person nga lista e stafit profesional mund ta kenë **licencën Al** por kjo mundesi sipas kerkesave në DT s'ka qenë e paraparë edhe tek menaxheri, gjë që PSH vlerëson se kërkesat përveq që kanë qenë të kjarta dhe jodiskriminuese të njëjtat janë edhe në diskrecionin e AK e cila në zbatim të dispozitës ligjore nga neni 9 i L.P.P-së ka të mundur vlerësoj/caktoj se a duhet të ketë licencë njëri nga stafi profesional apo duhet të këtë licencë menaxheri i projektit, kur jemi në dijeni se pozita e menaxherit është ajo e cila menaxhon, administron dhe udheheqë të gjithë projektin me qëllim që të arrihet qëllimi i atij projekti përderisa stafi profesional është ai i cili merret me punët specifike të paraqitura në atë projekt. Andaj,bazuar në elaborimet e dhëna si më lartë PSH konstaton se pretendimi ankimor i

parashtruar nga OE ankues është i pabazuar.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik është pjesërisht e bazuar i cili ka pretenduar se i njejti ka të drejtë të zevendsoj pozitën e menaxherit me pozitën e stafit profesional, ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK" lidhur me aktivitetin "Ndërhyrje restauruese dhe konservuese në objektet e Trashëgimisë Kulturore në gjithë Republikën e Kosovës - Faza e katërt" me nr. të prokurimit: 207-24-10543-5-1-1duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsyet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 , nenin 109 (e dreta në ankesë) dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 109 dhe 117 të LPP

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- OE - **TONI O.P.**
- Arkivës së OSHP-së: